

KMDK SH.A	Dalese <input type="checkbox"/>	Hyrëse <input type="checkbox"/>
Nr:	557 / 2017	
Data:	31.07.2017	
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A Kosovo Landfill Management Company J.S.C. Kompanija za Upravljanje Deponijama na Kosovu DOO		

Në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 138 të Ligjit Nr. 02-L-123 për Shoqëritë Tregtare, Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (Ligji Nr.05/ L-029), Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike (Ligji Nr. 03/L-048), në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 7 të Statutit të Kompanisë, si dhe në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Bordi i Drejtoreve të KMDK SH.A. miraton Rregulloren si më poshtë:

RREGULLORE NR. 10/2017 PËR PROVIZIONIMIN DHE SHLYERJEN E LLOGARIVE TË ARKËTUESHME DHE TË PAGUESHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohet forma dhe mënyra e provizionimit të llogarive të arkëtueshme dhe shlyerja e detyrimeve të pagueshme.

Neni 2

Në kuptim të kësaj rregulloreje, një borxh i keq do të konsiderohet atëherë kur:

- 1) Shuma që korrespondon me borxhin, më përpala është përfshirë në të hyra;
- 2) Kanë kaluar së paku 6 muaj nga afati i pagesës;
- 3) Nuk ka kontest mbi vlefshmërinë juridike të borxhit;
- 4) Borxhi është çregjistruar në libra si i padobishëm për qëllime kontabiliteti; dhe
- 5) Ka evidence të mjaftueshme se janë bërë përpjekje substanciale për të inkasuar borxhin, përfshirë çdo veprim të aplikueshëm për të maksimalizuar mbledhjen e borxhit sikurse janë:
 - a) Barazimi i çdo borxhi të pa kontestueshëm kundrejt borxhit të keq;
 - b) Korrespondenca dhe kontaktet në përpjekje për mbledhjen e borxhit;
 - c) Veprimi juridik ka qenë i pa suksesshëm apo është konsideruar si jo ekonomik për arsyet e dokumentuara.

Neni 3

Në kuptim të kësaj rregulloreje, nuk konsiderohet një borxh i keq siç është e përcaktuar në dispozitat e paragrafit 3 të nenit 12 nga ligji nr. 05/L-029 (Ligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave).

Neni 4
Detyrat dhe përgjegjësitë

1. ZKFTH dhe shërbimi i financave në kuadër të "KMDK-së" SH.A. është përgjegjës për implementimin e standardeve ndërkombe të kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Ndërkombe të Raportimit Financiar (SNRF) si dhe të gjitha procedurave dhe politikave kontabël të aprovuara nga Ndërmarrja.
2. Përmes kësaj rregulloreje, Ndërmarrja do të ketë një politikë të shlyerjes së llogarive të arkëtueshme në lidhje me kalkulimin e vjetërisë së llogarive të arkëtueshme dhe një kontrollë më të mirë ndaj kërkesave.
3. Ndërmarrja do të bëjë analiza të irregullta të vjetërisë së llogarive të arkëtueshme. Kjo do ti ndihmojë menaxhmentit që të përmirësojë arkëtimet dhe barazimet me klientët dhe të bëjë vlerësimë të sakta për provizione të borxheve të këqija.

Neni 5
Shpenzimet për borxhet e këqija

1. Regjistrimet akruale bëhen për të pasur mundësi për parashikimin e të hyrave nga shërbimet, shitjet si dhe zbritjet që i takojnë shërbimeve të kryera tanimë të konsumuara që nga data e raportimeve financiare.
2. Harmonizimi i duhur mund të arrihet vetëm nëse shpenzimi për borxhet e këqija është i regjistruar në periudhën e njëjtë fiskale me të hyrat ndaj të cilave kanë lidhshmëri.
3. Provizonimi do të bëhet nëse konsiderohet dhe konstatohet se ka kaluar vjetërsia e përcaktuar me dispozitat në fuqi për mbledhjen e borxheve.
4. Provizonimi bëhet në ngarkesë:
 - a) Debi(shpenzimet për borxhet e këqija).
 - b) Kredi (lejimet për borxhe).

Neni 6

1. Llogaritë e arkëtueshme dhe pagesat do të analizohen çdo tre muaj nga shërbimi i financave, për të filluar veprimet e nevojshme për mbledhjen e borxheve.
2. Llogaritë e arkëtueshme kalkulohen në baza vjetore të vlerësuara si të dyshimta dhe si borxhe të këqija.
3. Në bilancin e gjendjes "Vlera e llogarive të arkëtueshme" do të tregohet pas heqjes së lejimeve për llogari të arkëtueshme.

Neni 7
Procedurat e shlyerjes së borxhit të keq

1. ZKFTH dhe shërbimi i financave në pajtim me nenin 2 paragrafi 2. të kësaj rregulloreje, i drejtohet me kërkësë Bordit të Drejtorëve për shlyerjen e borxhit të keq.
2. Kërkësës i bashkëngjitet një raport analistik së bashku me faturën e përpiluar, me emërtimin "Borxh i keq", numrin e faturave të përfshira si dhe vlerën totale të tyre me të cilin lidhet ky borxh.
3. Për Shumën deri në pesëqind (500 euro) të trajtuar si borxh i keq nuk kërkohet inicim i procedurave në organet gjyqësore.
4. Llogaritë e arkëtueshme dhe pagesat do të rishikohen në fund të çdo viti finanziar për të siguruar se borxhet e dyshimta janë kontabilizuar në mënyrë adekuate.



Neni 8

Procedurat e Shlyerjes së Detyrimeve të Pagueshme dhe të Arkëtueshme

1. ZKFTH dhe shërbimi i financave, në pajtim me nenin 1 të kësaj rregulloreje që ka të bëjë me shlyerjen e detyrimeve të pagueshme, i drejtohet me kërkesë Bordit të Drejtorëve për aprovim.
2. Kërkesës i bashkëngjitet një raport analistik së bashku me faturën e përpiluar, me emërtimin "Për Shlyerjen e detyrimeve të pagueshme dhe të arkëtueshme", numrin e faturave të përfshira si dhe vlerën totale të tyre me të cilin lidhet ky borxh.
3. Shlyerja e detyrimeve të pagueshme dhe të arkëtueshme do të bëhet sipas dispozitave të Nenit 352 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhënie të detyrimeve.


Neni 9

Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

1. BD në KMDK SH. A. është organi kompetent për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje për procedurat e provisionimit të borxheve dhe të shlyerjes së detyrimeve.
2. Për çdo paqartësi apo konflikt të dispozitave të kësaj rregulloreje, Ligjet në fuqi dhe Statuti i Kompanisë mbizotërojnë mbi këtë rregullore. Në raste të tillë dispozitat përkatëse të kësaj rregulloreje konsiderohen të revokuara, ose ndryshuara në masën e nevojshme për eliminimin e mos përputhjes me ndonjë dispozite të Ligjeve apo Statutit të KMDK-se.
3. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën pasi të jetë miratuar nga Bordi i Drejtorëve dhe të jetë nënshkruar nga ana e Kryesuesit të Bordit të KMDK SH.A.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve në KMDK SH.A.

Lundrim Camaj



Prishtinë, 31/07 2017